

Drejtuar:  
Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit Ekonomik  
pranë Universitetit të Tetovës

**RAPORT I KOMISIONIT RECENSUES PËR ZGJEDHJE/RIZGJEDHJE TË NJË  
MËSIMDHËNËSI NË TË GJITHA THIRRJET MËSIMORE-SHKENCORE NË LËMIT  
MENAXHMENT STRATEGJIK – 50605, MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE – 50622,  
DHE BIZNIS MENAXHMENT – 50603  
NË FAKULTETIN EKONOMIK PRANË UNIVERSITETIT TË TETOVËS**

Në bazë të konkursit të shpallur më datë 09.Qershor.2021, në gazetën ditore “Koha” dhe “Sloboden pečat”, dhe në faqen zyrtare të Universitetit të Tetovës, Këshilli Mësimor Shkencor i Fakultetit Ekonomik në mbledhjen e mbajtur më 18.Qershor.2021, ka sjell Vendim për formim të Komisionit recensues me nr. 14-611/1, për zgjedhjen e një mësimdhënësi në lëmit Menaxhment strategjik – 50605, Menaxhimi i burimeve njerëzore – 50622 dhe Biznis menaxhment – 50603 (komform klasifikimit të sferave, fushave dhe lëmejeve shkencore hulumtuese sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit) në përbërje:

1. Prof.dr. Etem Iseni, Profesor ordinar në Fakultetin Ekonomik pranë Universitetit të Tetovës.
2. Prof.dr. Leonid Nakov, Profesor ordinar në Fakultetin Ekonomik pranë Universitetit “Shën Kirili e Metodij” në Shkup,
3. Prof.dr. Izet Zeqiri, Profesor ordinar në Fakultetin e Biznesit dhe Ekonomisë pranë Universitetit të Evropës Juglindore dhe Anëtar korenspondues i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Maqedonisë

Pas pranimit të dokumentacionit të dorëzuar, komisioni në fjalë vërtetoi se në konkurs është paraqitur vetëm një kandidat:

1. Prof.Dr. Brikend Aziri, aktualisht profesor inordinar për lëndët Menaxhmenti strategjik, menaxhimi i burimeve njerëzore dhe marketing menaxhment në Fakultetin Ekonomik pranë Universitetit të Tetovës, me Fletë aplikimi nr. 04/01/13 të datës 09.06.2021.

Komisioni pasi që konstatoi se dosja e aplikimit përmban në tërësi dokumentacionin e rregullt të paraparë komfor kërkesave të konkursit, paraqet këtë:

## **RAPORT RECENSUES**

Më datë 09.Qershor.2021, në gazetata ditore "Koha" dhe "Sloboden pečat", dhe në faqen zyrtare të Universitetit të Tetovës, është shpallur konkurs për zgjedhjen e një mësimdhënësi në lëmit Menaxhment strategjik – 50605, Menaxhimi i burimeve njerëzore – 50622 dhe Biznis menaxhment – 50603 (komform klasifikimit të sferave, fushave dhe lëmeve shkencore hulumtuese sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit).

Bazuar në dokumentacionin e pranuar, të kandidatit Prof.dr. Brikend Aziri komisioni paraqet referat me të dhëna si më poshtë.

### **Të dhëna biografike**

Prof.dr. Brikend Aziri ka lindur më 22.11.1983 në fshatin Turçan i Madh ( Bellovishtë) të Gostivarit. Arsimin fillorë e ka kryer në shkollën fillore „Bashkimi“ në Gostivar. Arsimin e mesëm e ka kryer në periudhën 1997-2000 në Shkollën e Mesme Komunale „Gostivari“ në Gostivar në drejtimin matematikorë-natyrorë si nxënës i dalluar i gjeneratës. Në vitin akademik 2000/2001 regjistron studimet universitare në drejtimin e menaxhmentit në Fakultetin Ekonomik pranë Universitetit „Shën Kirili e Metodij“ në Shkup ku diplomon më datë 05.10.2004 me mbrojtjen e punimit të diplomës në temë „ Qeverisja korporative“ më çka e merë gradën shkencore i Diplomuar në Shkencat Ekonomike (BSc) nga fusha e Menaxhmentit. Në vitin 2005 regjistron studimet pasdiplomike në Fakultetin Ekonomik pranë Universitetit „Shën Kirili e Metodij në Shkup“. Më datë 06.11.2007 me sukses mbron disertacionin e magjistraturës në temë „Satisfakcioni nga puna si faktor për motivimin e punëtorëve“ dhe merr gradën shkencore Magjistër i Shkencave Ekonomike (MSc) nga fusha e menaxhmentit. Më 17.11.2010 Brikend Aziri mbroji me sukses punimin e doktoratës në temë „Modele për shpërblimin e bordit të drejtorëve“ në Fakultetin Ekonomik pranë Universitetit „Shën Kirili e Metodij“ në Shkup.

Prof. dr. Brikend Aziri menjëherë pas diplomimit punësohet në Komunën e Gostivarit si Bashkëpunëtorë i ri për evidentimin dhe ndjekjen e tatimeve lokale ku punon në periudhën Tetor.2004-Prill.2005. Në periudhën Janar.2005-Qershor.2005 ka punuar në Asociacionin për Iniciativa Qytetare (ADI) si ndihmës menaxher për implementimin e projektit „Qendra për të drejtat e njeriut pranë Universitetit të Evropës Juglindore në Tetovë. Në Tetor.2005 punësohet në pozitën Asistent i ri për grup lëndësh nga fusha e menaxhmentit në Fakultetin e Biznesit dhe Ekonomisë pranë Universitetit të Evropës Juglindore. Në periudhën 14.11.2008-14.11.2011 ka punuar si Asistent për grup lëndë nga fusha e menaxhmentit në Fakultetin e Biznesit dhe Ekonomisë pranë Universitetit të Evropës Juglindore.

Nga 12.04.2011 deri më 12.04.2014 ka punuar Docent për grup lëndë nga fusha e menaxhmentit dhe qeverisjes korporative në Fakultetin e Biznesit dhe Ekonomisë pranë Universitetit të Evropës Juglindore. Më 12.04.2016 zgjidhet në thirrjen Mësimore-Shkencore Profesor inordinar për grup lëndë nga fusha e menaxhmentit dhe qeverisjes korporative në Fakultetin e Biznesit dhe Ekonomisë pranë Universitetit të Evropës Juglindore. Më 07.12.2016 zgjidhet në thirrjen Mësimore-Shkencore Profesor inordinar për lëndët:

Menaxhment strategjik, menaxhimi i burimeve njerëzore dhe marketing menaxhment në Fakultetin Ekonomik pranë Universitetit të Tetovës, detyrë që kryen aktualisht.

Pos kësaj, ai ushtron mandatin e dytë të Prodekanit për arsim në fakultetin Ekonomik pranë Universitetit të Tetovës. Ka shërbyer dhe në cilësinë e Ushtruesit të Detyrës Dekan i Fakultetit Ekonomik pranë Universitetit të Tetovës. Ai gjithashtu ka qenë anëtarë i këshillit Komunal të komunës së Gostivarit si dhe anëtarë i Komisionit për zhvillim ekonomik lokal pranë këshillit Komunal të Gostivarit.

## **Mësimdhënia dhe veprimtaria arsimore**

Veprimtaria mësimore e Prof. Dr. Brikend Aziri mund të përshkruhet si mjaft e bujshme, aktive dhe e suksesshme. Në fakt, kandidati në fjalë ka një përfshirje në mësimdhënie si brenda po ashtu edhe jashtë vendit.

Në periudhën pas marrjes së Thirrjes mësimore -shkencore Profesor inordinar në Fakultetin Ekonomik pranë Universitetit të Tetovës, dr. Brikend Aziri ka ligjëruar një sërë të lëndëve në studimet e ciklit të parë, të dytë dhe të tretë në Universitetin e Tetovës, Universitetin e Evropës Juglindore, Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë, Kolegjin "Dardania" në Prishtinë dhe Fakultetin Ekonomik të Suboticës, Dega në Bujanoc.

Në Universitetin e Tetovës, Prof.dr. Brikend Aziri në periudhën në fjalë ka ligjëruar në vazhdimësi në studimet e ciklit të parë në lëndët: Bazat e menaxhmentit, menaxhimi i burimeve njerëzore, menaxhmenti strategjik dhe marketing menaxhmenti si dhe në lëndën menaxhmenti ndërkombëtar. Në ciklin e dytë të studimeve në vazhdimësi ka ligjëruar lëndët: Menaxhimi strategjik i burimeve njerëzore, menaxhimi i strategjive të biznesit, menaxhimi i institucioneve publike dhe qeverisja korporative. Në studimet e ciklit të tretë pranë institucionit në fjalë Prof.dr. Brikend Aziri ka ligjëruar lëndët: Menaxhmenti strategjik dhe qeverisja korporative.

Në Universitetin e Evropës Juglindore në studimet e ciklit të parë ka ligjëruar lëndën Menaxhimi i burimeve njerëzore në gjuhë shqipe, maqedonase dhe angleze; në studimet e ciklit të dytë lëndët: Menaxhimi i burimeve njerëzore, qeverisja korporative dhe Mendimi kritik dhe etika; ndërsa në studime të ciklit të tretë lëndën Teoria e organizatës: Një qasje multidisiplinare.

Në periudhën në fjalë, Prof.dr. Brikend Aziri në kolegjin "Dardania" në Prishtinë, në studimet e ciklit të parë ka ligjëruar lëndët: Menaxhmenti financiar, Menaxhimi i institucioneve publike dhe etika e biznesit, ndërsa në studimet e ciklit të dytë lëndën Menaxhmenti administrativ dhe biznesor.

Në Fakultetin e Biznesit dhe Ekonomisë pranë Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, Prof.dr. Brikend Aziri në periudhën në fjalë në studimet e ciklit të dytë ka ligjëruar lëndët: Komunikimi i brendshëm menaxherial, Lidhshipi, Menaxhimi i modeleve të kompetencës, Teori bashkëkohore të organizimit, Menaxhmenti strategjik i avancuar dhe Menaxhimi strategjik i burimeve njerëzore.

Në Fakultetin Ekonomik të Suboticës, Dega në Bujanoc ka ligjëruar në studimet e ciklit të parë lëndët: Bazat e menaxhmentit dhe Menaxhmenti strategjik. Ai në vazhdimësi ka zhvilluar konsultat dhe ka pajisur studentët me materiale përkatëse leximi dhe studimi në lëndët në fjalë.

Prof.dr. Brikend Aziri në ndëkohë ka zhvilluar cikël të leksioneve në Menaxhim të burimeve njerëzore në Professional Logistics & Supply Chain Management si dhe cikël të leksioneve për përmirësim të cilësisë së mësimdhënies te shkollat e mesme në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Ai ka shërbyer si profesor vizitues në Fakultetin Ekonomik të Suboticës për lëndën Menaxhmenti strategjik tre semestra në radhë.

Prof.dr. Brikend Aziri ka mentoruar gjithsej 19 kandidatë në përpilimin dhe mbrojtjen me sukses të punimeve të diplomës në Fakultetin Ekonomik pranë Universitetit të Tetovës si dhe ka qenë anëtarë i komisionit për shqyrtim dhe mbrojtje në 11 sosh. Në periudhën në fjalë, Prof.dr. Brikend Aziri ka mentoruar 24 punime magjistrature të mbrojtura me sukses në Fakultetin Ekonomik pranë Universitetit të Tetovës, Fakultetin e Biznesit dhe Ekonomisë pranë Universitetit të Evropës Juglindore dhe në Fakultetin e Biznesit pranë Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë. Në po të njëjtat institucione ai ka qenë anëtar i komisionit për shqyrtim dhe mbrojtje në 27 punime të magjistraturës. Ai kë shërbyer në cilësinë e kryetarit dhe anëtarit të komisionit për shqyrtim dhe mbrojtje të pesë disertacioneve të doktoratës në Fakultetin Ekonomik pranë Universitetit të Tetovës, Fakultetin e Biznesit dhe Ekonomisë pranë Universitetit të Evropës Juglindore dhe Fakultetin Ekonomik pranë Universitetit "Hasan Prishtina" në Prishtinë.

Prof.dr. Brikend Aziri, në këtë periudhë ka publikuar dy tekste universitare:

- Brikend Aziri: "Qeverisja e korporatave", Universiteti i Tetovës, Tetovë, 2020
- Halit Shabani, Brikend Aziri, Raman Ismaili, Ibish Mazreku: Qeverisje korporative: Qeverisja me shoqëritë aksionare në Republikën e Kosovës

Pos teksteve universitare në fjalë, Prof.dr. Brikend Aziri në këtë periudhë ka përpiluar nëntë skripta interne për ligjërata, me çka ka dhënë kontribut në ndërtimin e bazës së literaturës për servisim të një sërë lëndë nga lëmi i menaxhimit të burimeve njerëzore, menaxhmentit strategjik dhe biznes menaxhmentit.

*Siç mundet të vërehet dhe nga tabelat në shtojcë të raportit, Prof. dr. Brikend Aziri në periudhë në fjalë ka grumbulluar gjithsej 313.9 pikë në pjesën e veprimtarisë së tij mësimdhënëse dhe arsimore.*

## Veprimtaria shkencore-hulumtuese

Në periudhën pas marrjes së thirrjes mësimore-shkencore Profesor inordinar në Fakultetin Ekonomik pranë Universitetit të Tetovës, prof.dr. Brikend Aziri ka shënuar suksese adekuatë edhe në pjesën e veprimtarisë shkencore-hulumtuese.

Në këtë drejtim, ai në vazhdimësi ka kontribuar në ndërtimin e gjeneratave të reja të hulumtuesve përmes mentorimit të disertacioneve në ciklin e tretë në Fakultetin Ekonomik pranë Universitetit të Tetovës si dhe punimeve të magjistraturës në Fakultetin Ekonomik pranë Universitetit të Tetovës, Fakultetin e Biznesit pranë Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejë dhe Fakultetin e Biznesit dhe Ekonomisë pranë Universitetit të Evropës Juglindore. Kështu, në rrjedhë ka të raportuara tre mentorime të disertacioneve të doktoratës dhe 13 disertacioneve të magjistraturës.

Në periudhën në fjalë Prof.dr. Brikend Aziri ka të publikuara një varg të punimeve shkencore në revista relevante ndërkombëtare dhe vendore, edhe atë:

- Изет Зеќири, Брикенд Азири, Јетон Мазлами: „Корпоративното управување и перформансата на современите корпорации,, Прилози, L 1-2, Македонска Академија на Науките и Уметностите, 2020, ISSN: 0350-1698
- Изет Зеќири, Брикенд Азири, Јетон Мазлами: „Физичкото и вербалното насилство на работа како облици на мобинг кај вработените во Полошкиот регион,, Прилози, бр. XLVII Vol. 2, Македонска Академија на Науките и Уметностите, 2017, ISSN: 0350-1698
- Brikend Aziri, Raman Ismaili, Etem Iseni: The Leader's Role in Fostering and Managing Organizational Changes. International Journal: Knowledge, Vol. 17.1. No.1, ISSN: 2545-4439, pp. 391-396
- Raman Ismaili, Brikend Aziri, Etem Iseni: Online Promotion: An Underdeveloped Tool in the Pollog Region. International Journal: Knowledge, Vol. 17.2. No.2, ISSN: 2545-4439, pp. 983-986
- Izet Zeqiri, Brikend Aziri, Jeton Mazllami: Time management among managers in the Pollog region. Review of Innovation and Competitiveness. Vol. 3, Issue 3, ISSN: 1849-8795, pp. 39-46
- Brikend Aziri, Jeton Mazllami, Arber Sulejmani: Emerging Issues in Leadership, The AuroAsia Proceedings of Educational and Social Sciences, 2016, Vol.5, ISSN: 2587-1730, pp.364-370
- Jeton Mazllami, Izet Zeqiri, Brikend Aziri: Managing of the 2008 Financial Crisis by the Government of the Republic of Macedonia and its impact on the Business Sector, Globalization and Business, Vol. 03, 2017, ISSN:2449-2396 , pp. 36-43
- Raman Ismaili, Brikend Aziri: Marketing strategies among companies in the Pollog region, Economic Vision, Vol 05, No. 9&10, 2018, ISSN: 1857-9556, pp. 150-159
- Raman Ismaili, Brikend Aziri, Aida Yzeiri Baffijari: Marketing research among companies in the Pollog region, Economic Vision, Vol.06, No, 11/12 (2019), ISSN: 1857-9556, pp. 149-159
- Aida Yzeiri Baffijari, Raman Ismaili, Brikend Aziri: Client expectations and preferences for service quality dimensions in bank services in Republic of North Macedonia, Economic Vision, Vol.7, No. 13/14, ISSN: 1857-9566, pp. 13-21

- Brikend Aziri, Raman Ismaili: Business environment analysis as a key stage in the process of strategic management, Economic Vision, Vol.7, No. 13/14, ISSN: 1857-9566, pp. 99-110, ISSN:
- Jeton Mazllami, Brikend Aziri: Investment's efficiency and economic growth: A comparative analysis of North Macedonia and Albania, Knowledge, Vol.31.5, 2019, pp.1381-1389, ISSN: 2545-4439
- Brikend Aziri, Izet Zeqiri: The very essentials of strategic management tools, Economic Vision, Vol.7, No. 13/14, ISSN: 1857-9566, pp. 87-98
- Jeton Mazllami, Izet Zeqiri, Brikend Aziri: The New Model of Local Economic Development of the Municipality of Tetovo: A Comparative Analysis Between Tetovo and Maribor, Knowledge – International Journal, Vol. 26.1, September, 2018
- Brikend Aziri, Arlinda Mazllami: Direct Marketing Among Companies in the Pollog Region, Knowledge – International Journal, Vol. 26.1, September, 2018

Në periudhën në fjalë Prof.dr. Brikend Aziri ka të publikuara një varg të punimeve shkencore në përmbledhje të punimeve nga takime shkencore/profesionale me bord editorial vendor dhe ndërkombëtarë:

- Raman Ismaili, Brikend Aziri, Isak Ajruli : Cilësia e arsimit të lartë dhe tregu i punës në Republikën e Maqedonisë, Sistemi i arsimit, tregu i punës dhe zhvillimi ekonomik - sfidat dhe perspektivat Akademia e Shkencave dhe Arteve të Republikës së Kosovës, 2019, ISBN: 978-9951-26-006-0
- Izet Zeqiri, Brikend Aziri: Geographical and Ethnical Discrepancies in Fighting Unemployment in the Republic of Macedonia, Proceeding Book: International Conference of Research in Education and Science, December, 2016, fq. 932-937, ISBN:978-605-66950-2-5
- Raman Ismaili, Brikend Aziri, Ibish Mazreku: Brand Management in the Hospitality Industry in the Republic of Macedonia. Fourth International Multidisciplinary Scientific Conference on Social Sciences and Arts – SGEM 2017, Volume IV, ISSN: 2367-5659, pp. 99-107
- Brikend Aziri, Raman Ismaili: The Changing Nature of Leadership, Fourth International Multidisciplinary Scientific Conference on Social Sciences and Arts – SGEM 2017, Volume V, ISSN: 2367-5659, pp. 967-972
- Izet Zeqiri, Jeton Mazllami, Brikend Aziri: Tregu i punës në Republikën e Maqedonisë në rrugën drejt Bashkimit Evropian: Republika e Maqedonisë në rrugën drejt Bashkimit Evropian (2020)-Përvoja, sfida dhe perspektiva, Dhjetor, 2016, ISBN:978-608-203-180-4
- Izet Zeqiri, Brikend Aziri: Leadership Attributes Among Entrepreneurs In The Pollog Region, Economic Development And Entrepreneurship In Transition Economies: Is free trade working for transitional and developing economies?, Faculty of Economics, University of Banja Luka, May, 2017, ISBN 978-99938-46-54-3
- Brikend Aziri, Izet Zeqiri: Corporate governance in North Macedonia, Albania and Kosovo: A comparative analysis, 4th International Scientific Conference on Business and Information Technologies, South East European University, 2021, ISSN: 2671-373X

Prof.dr. Brikend Aziri, në periudhën në fjalë ka participuar me referate në 16 tubime shkencore/profesionale me bord editorial lokal dhe ndërkombëtar dhe ka publikuar 11 abstrakte në suaza të njëjtave, edhe atë:

- International Conference of Research in Education and Science, Bodrum, , 2016
- International Scientific Conference The Teacher of the Future, Budva, May, 2017
- REDETE 2016, Beograd, December, 2016
- Building Bridges Between Business Research And Industry Needs, Tetovo, February, 2017
- Second International Conference Actual Problems in Knowledge Economy in Modern Globalization, Tbilisi, Georgia, September, 2017
- Forth International Multidisciplinary Scientific Conference on Social Sciences and Arts SGEM 2017, Albena, September, 2017
- Government policies and economic development - South –East Europe region, Peja, November, 2017
- 5th International Scientific Conference “Challenges of Doing Business in the Contemporary World”– CDBCW 2017
- Eighth International Scientific Conference “Economic Policy and EU Integration”- ISCBF 2018, 4-5.May.2018. Dures
- International Scientific Conference on Business and Economics, Tetovo, May, 2018
- Eighteenth International Scientific Conference “The teacher of the future”, Thesaloniki, September, 2018
- Sixth International Scientific Conference “Economic Development as a Precondition for EU Integration”, Tetovo, October, 2018
- Education System, Labor Market and Economic Development: Challenges and Prospects, Prishtina, October, 2018
- 4th International Scientific Conference on Business and Information Technologies (ISCBIT 2020)
- 7th International Scientific Conference “Contemporary Economic Trends”– Cet2019
- Предизвиците на фискалната политика во периодот на пандемијата од ковид-19 и перспективи во посткризниот период, 2021

Prof.dr. Brikend Aziri ka zhvilluar një leksion seksioni në tubim shkencor/profesional me bord editorial dhe pjesëmarrje ndërkombëtare:

- 18<sup>th</sup> International Scientific Conference “The Power of Knowledge”, Agia Triada Greece, September 27-19.2018

Ai në këtë periudhë ka publikuar dy monografi profesionale dhe është autor kapitulli në një monografi profesionale, dhe atë:

- Brikend Aziri, Raman Ismaili: Strategy: A necessity for companies in the Republic of North Macedonia, Lambert Academic Publishing, 2020, ISBN: 978-620-2-55439-8
- Љупчо Коцарев, Изет Зеќири, Брикенд Азири, Јетон Мазлами: Ефективноста на учењето од далечина: Наставата и учењето од далечина кај високообразовните институции во Република Северна Македонија пред и во екот на КОВИД 19, МАНУ, 2021. ISBN: 978-608-203-315-0
- Изет Зеќири, Брикенд Азири, Јетон Мазлами: Функционирањето на регулаторните тела во Република Северна Македонија, нивната независност

– компаративно искуство, Економски медитации, МАНУ, Скопје 2020. ISBN: 978-608-203-307-5

*Siç mundet të vërehet dhe nga tabelat në shtojcë të raportit, Prof. dr. Brikend Aziri në periudhën në fjalë ka grumbulluar gjithsej 213.9 pikë në pjesën e veprimtarisë shkencore-hulumtuese.*

### **Veprimtaria profesionale artistike aplikative**

Veprimtaria profesionale artistike-aplikative e Prof. dr. Brikend Aziri në periudhën pas marrjes së thirrjes Profesor inordinar, kryesisht vjen në shprehje përmes kontributit të tij të vazhdueshëm në përpilimin dhe promovimin e programeve studimore të Fakultetit Ekonomik pranë Universitetit të Tetovës. Kështu ai ka koordinuar përpilimin e programeve vijuese studimore në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve:

- Menaxhimi i burimeve njerëzore / Master – 60 kredi / 2017
- Menaxhment / Master – 60 kredi / 2017
- Marketing dhe menaxhment / Master – 120 kredi / 2017
- MBA / Master/ 60 kredi/2017
- Marketing dhe menaxhment / Studime deridiplomike/2020
- Ekonomi dhe biznes / Studime deridiplomike / 2020
- Menaxhimi i burimeve njerëzore / Master – 60 kredi / 2021
- Menaxhment / Master – 60 kredi / 2021
- Marketing dhe menaxhment / Master – 120 kredi / 2021

Pos kësaj, Prof.dr. Brikend Aziri ka recensionuar tekstin shkollor vijues për shkollat e mesme në Republikën e Maqedonisë së Veriut:

- Секретарско работење за IV година: Економска, правна и трговска струка

*Siç mundet të vërehet dhe nga tabelat në shtojcë të raportit, Prof. dr. Brikend Aziri në periudhën në fjalë ka grumbulluar gjithsej 24 pikë nga veprimtaria profesionale artistike aplikative.*

### **Veprimtaria me interes më të gjerë**

Në periudhën e deritanishme Prof. dr. Brikend Aziri në vazhdimësi ka qenë anëtar i bordit editorial në revistat vijuese shkencore ndërkombëtare:

- Journal of Advanced Research in Management, ASERS Publishing, Romania
- Journal of Advanced Research in Economics and International Business
- Journal of Investment and Management, ISSN: 2328-7713 (Print); ISSN: 2328-7721 (Online)
- International Journal of Business Research and Management (IJBRM), ISSN – 2180-2165
- Journal of Finance and Accounting, ISSN (Print): 2333-8849 ISSN (Online): 2333-8857
- Journal of investment and management
- Economic Vision



Në këtë periudhë Prof. dr. Brikend Aziri, në mënyrë aktive ka qenë i kyçur në organizimin e tubimeve shkencore me bord editorial dhe prezencë ndërkombëtare, edhe atë:

- 1st International Scientific Conference on Business and Economics (ISCBE'17) "Building Bridges between Business Research and Industry Needs"; 17 – 18 February, 2017; FBE-SEEU; Tetovo
- Managing Innovation and Diversity in Knowledge Society Through Turbulent Time; 25–27 May 2016; Timisoara; Romania
- The Economic Effects Of Migration Processes In The Western Balkans; 2.December.2016, University of Tetovo
- First International Congress on Tourism, Economic and Business Sciences, 01.-05.November. 2017, University in Tetovo and University of Krems
- Government Policies and Economic Development – South East European Region. 17.November.2017, University "Haxhi Zeka" and University of Tetovo
- 5th International Scientific Conference "Challenges of Doing Business in the Contemporary World" – CDBCW2017, 01 – 02 December, 2017, University of Tetovo
- 3RD INTERNATIONAL CONGRESS On SOCIAL AND ECONOMIC SCIENCES, 15 – 19 November 2017, Marmara University
- International Congress on Tourism, Economic and Business Science, 01-04.November.2018
- International Congress on Tourism, Economic and Business Science, 01-02-22.June.2019
- International Congress on Human, Social Sciences and Arts, November, 2019, Seventh International Conference "Contemporary Economic Trends"
- World Summit on Management Sciences, June.29-30. Thailand
- Fifth International Scientific Conference in Business and Economics: Balancing the Economic Cycle in a Pandemic State: Lessons Learned and Future Actions, (BECON 2020), Peja, Republic of Kosovo

Vlen të theksohet fakti se Prof. dr. Brikend Aziri ka shërbyer në cilësinë e Ushtruesit të Detyrës Dekan i Fakultetit Ekonomik pranë Universitetit të Tetovës si dhe është duke ushtruar mandatin e dytë në cilësinë e Prodekanit për arsim pranë po të njëjtit institucion. Ai është edhe anëtarë i Këshillit për bashkëpunim dhe besim me publikun në Fakultetin Ekonomik pranë Universitetit të Tetovës si dhe ka qenë anëtar dhe kryetar i më shumë komisioneve për zgjedhje dhe rizgjedhje të mësimdhënësve në Fakultetin Ekonomik pranë Universitetit të Tetovës dhe Fakultetin e Biznesit pranë Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë.

*Siç mundet të vërehet dhe nga tabelat në shtojcë të raportit, Prof. dr. Brikend Aziri në periudhën në fjalë ka grumbulluar gjithsej 37.5 pikë nga veprimtaria me interes më të gjerë.*

## Përfundimi dhe propozimi

Në bazë të pasqyrës së prezantuar më lartë, si dhe nga të dhënat në shtojcë, Komisioni Recensues i vlerëson pozitivisht aktivitetet në veprimtarinë mësimore dhe arsimore, shkencore e hulumtuese, aplikuese profesionale dhe veprimtarinë me interes më të gjerë dhe konstaton se kandidati **Prof. Dr. Brikend Aziri** në përputhje me Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore-mësimore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorit në Universitetin e Tetovës, ka grumbulluar gjithsejtë 589.3 pikë nga referencat profesionale. Me këtë e ka tejkaluar numrin e nevojshëm të pikëve që duhet të realizohen, për zgjedhjen në thirrjen mësimore-shkencore **Profesor Ordinar**.

Duke u bazuar në të dhënat e mësipërme për aktivitetin e përgjithshëm të kandidatit, Komisioni recensues konstaton se: **Prof. dr. Brikend Aziri** posedon cilësi shkencore-profesionale bazuar në Ligjin për Arsim të Lartë të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe në përputhje me Rregulloren për kriteret e veçanta për procedurën për zgjedhje në thirrjet mësimore-shkencore, shkencore-mësimore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorit në Universitetin e Tetovës. Komisioni ka verifikuar se kandidati **Prof. dr. Brikend Aziri** i plotëson të gjitha kushtet për t'u zgjedhë në thirrjen **Mësimore-Shkencore Profesor ordinar**.

Komisioni Recensues ka nderin dhe kënaqësinë t'i propozojë Këshillit Mësimorë-Shkencorë të Fakultetit Ekonomik pranë Universitetit të Tetovës, që kandidati **PROF. DR. BRIKEND AZIRI** të zgjidhet në thirrjen mësimore shkencore **PROFESOR ORDINAR** në lëmit: **MENAXHMENT STRATEGJIK – 50605, MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE – 50622 DHE BIZNIS MENAXHMENT – 50603**, në të gjitha programet studimore në Fakultetin Ekonomik pranë Universitetit të Tetovës.

Tetovë, Qershor.2021

Komisioni:

Prof.dr. Etem Iseni, Kryetar

Prof.dr. Leonid, Nakov, Anëtar

Prof.dr. Izet Zeqiri, Anëtar

**Prof. Dr. Brikend Aziri**

**MËSIMDHËNIA DHE VEPRIMTARIA ARSIMORE**

Aktiviteti	Kalkulimi	Pikë
<b>ZHVILLIMI I LIGJËRATAVE</b>		
<b>Zhvillimi i ligjëratave në ciklin e parë të studimeve</b>		
<b>Viti akademik 2016 - 2017</b>		
<i>Universiteti i Tetovës</i>		
Menaxhimi i burimeve njerëzore	2X15X0.04	1.2
Menaxhimi strategjik	2X15X0.04	1.2
Menaxhmenti ndërkombëtarë	2X15X0.04	1.2
<i>Universiteti i Evropës Juglindore</i>		
Menaxhimi i burimeve njerëzore (Në gjuhë shqipe)	3x15x0.04	1.8
Menaxhimi i burimeve njerëzore (Në gjuhë maqedonase)	3x15x0.04	1.8
<i>Kolegji "Dardania" në Prishtinë</i>		
Menaxhmenti financiar	3x15x0.04	1.8
Menaxhimi i institucioneve publike	3x15x0.04	1.8
Etika e biznesit	3x15x0.04	1.8
<b>Viti akademik 2017 - 2018</b>		
<b>Semestri dimëror</b>		
<i>Universiteti i Tetovës</i>		
Menaxhimi strategjik	3x15x0.04	1.8
Menaxhimi i marketingut	2X15X0.04	1.2
Konceptet e menaxhmentit	2X15X0.04	1.2
<b>Semestri veror</b>		
<i>Universiteti i Tetovës</i>		
Menaxhimi i burimeve njerëzore	2X15X0.04	1.2
Menaxhmenti strategjik	2X15X0.04	1.2
Bazat e menaxhmentit	2X15X0.04	1.2
<i>Fakulteti Ekonomik i Suboticës, Dega në Bujanoc</i>		
Bazat e menaxhmentit	2X15X0.04	1.2
<i>Universiteti i Evropës Juglindore</i>		
Human Resources Management - LSE	3x15x0.04	1.8
<b>Viti akademik 2018 - 2019</b>		
<b>Semestri dimëror</b>		
<i>Universiteti i Tetovës</i>		
Menaxhimi strategjik	3x15x0.04	1.8
Menaxhimi i marketingut	2X15X0.04	1.2
Konceptet e menaxhmentit	2X15X0.04	1.2
<b>Semestri veror</b>		
<i>Universiteti i Tetovës</i>		
Menaxhmenti strategjik	2X15X0.04	1.2
Menaxhimi i burimeve njerëzore	2X15X0.04	1.2
Bazat e menaxhmentit	2X15X0.04	1.2
<i>Fakulteti Ekonomik i Suboticës, Dega në Bujanoc</i>		

Menaxhmenti strategjik	2X15X0.04	1.2
<b>Viti akademik 2019 - 2020</b>		
<b>Semestri dimëror</b>		
<i>Universiteti i Tetovës</i>		
Menaxhimi strategjik	3x15x0.04	1.8
Menaxhimi i marketingut	2X15X0.04	1.2
Menaxhimi i burimeve njerëzore	2X15X0.04	1.2
<i>Fakulteti Ekonomik i Suboticës, Dega në Bujanoc</i>		
Menaxhmenti strategjik	2X15X0.04	1.2
<b>Semestri veror</b>		
<i>Universiteti i Tetovës</i>		
Menaxhimi i burimeve njerëzore	2X15X0.04	1.2
Menaxhimi strategjik	2X15X0.04	1.2
Bazat e menaxhmentit	2X15X0.04	1.2
<b>Viti akademik 2020 - 2021</b>		
<b>Semestri dimëror</b>		
<i>Universiteti i Tetovës</i>		
Menaxhimi strategjik	3x15x0.04	1.8
Menaxhimi i burimeve njerëzore	2X15X0.04	1.2
<i>Fakulteti Ekonomik i Suboticës, Dega në Bujanoc</i>		
Menaxhimi strategjik	5x15x0.04	3.0
<b>Semestri veror</b>		
<i>Universiteti i Tetovës</i>		
Bazat e menaxhmentit	2X15X0.04	1.2
Menaxhmenti strategjik	2X15X0.04	1.2
Menaxhimi i burimeve njerëzore	2X15X0.04	1.2
<b>Zhvillimi i ligjëratave në ciklin e dytë të studimeve</b>		
<b>Viti akademik 2016 - 2017</b>		
<i>Universiteti i Tetovës</i>		
Menaxhimi strategjik i burimeve njerëzore	2x10x0.05	1
Menaxhmenti ndërkombëtar	3x7x0.05	1
<i>Universiteti i Evropës Juglindore</i>		
Qeverisja korporative (Kampusi në Tetovë)	3x8x0.05	1.2
Qeverisja korporative (Kampusi në Shkup)	3x8x0.05	1.2
Mendimi kritik dhe etika	3x8x0.05	1.2
Menaxhimi i resurseve humane (Kampusi në Tetovë)	3x8x0.05	1.2
Menaxhimi i resurseve humane (Kampusi në Shkup)	3x8x0.05	1.2
<i>Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejë</i>		
Komunikimi i brendëshëm menaxherial	5x15x0.05	3.75
Lidershipi	5x15x0.05	3.75
<i>Kolegji "Dardania" në Prishtinë</i>		
Menaxhmenti administrativ dhe biznesor	3x8x0.05	1.2
<b>Viti akademik 2017- 2018</b>		
<b>Semestri dimëror</b>		
<i>Universiteti i Evropës Juglindore</i>		
Qeverisja korporative (Kampusi në Tetovë)	1x8x0.05	0.4

Qeverisja korporative (Kampusi në Shkup)	3x8x0.05	1.2
<i>Universiteti i Tetovës</i>		
Menaxhimi strategjik i burimeve njerëzore	3x7x0.05	1
<i>Universiteti "Haxhi Zeka"</i>		
Menaxhimi i modeleve të kompetencës	5X14X0.05	3.5
<b>Semestri veror</b>		
Menaxhimi i strategjive të biznesit	3x7x0.05	1
<b>Viti akademik 2018– 2019</b>		
<b>Semestri dimëror</b>		
Qeverisja korporative	3x7x0.05	1
Menaxhimi strategjik i burimeve njerëzore	3x7x0.05	1
<b>Semestri veror</b>		
Menaxhimi i strategjive të biznesit	3x7x0.05	1
<b>Viti akademik 2019– 2020</b>		
<i>Semestri dimërorë</i>		
Menaxhimi strategjik i burimeve njerëzore	3x7x0.05	1
<i>Semestri verorë</i>		
Menaxhimi i strategjive të biznesit	3x7x0.05	1
Zhvillimi i burimeve njerëzore	3x7x0.05	1
<b>Viti akademik 2020– 2021</b>		
<i>Semestri dimërorë</i>		
<i>Universiteti i Tetovës</i>		
Menaxhimi i institucioneve publike	3x7x0.05	1
Menaxhimi strategjik i burimeve njerëzore	3x7x0.05	1
<i>Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejë</i>		
Menaxhimi i modeleve të kompetencës	3x15x0.05	2.25
Teoritë bashkëkohore të organizimit	3x15x0.05	2.25
<i>Semestri verorë</i>		
<i>Universiteti i Tetovës</i>		
Qeverisje korporative	3x7x0.05	1
<i>Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejë</i>		
Menaxhimi strategjik i avancuar	3x15x0.05	2.25
Menaxhimi strategjik i burimeve njerëzore	2x15x0.05	1.5
<b>Zhvillimi i ligjëratave në ciklin e tretë të studimeve</b>		
<b>Viti akademik 2017– 2018</b>		
<b>Semestri dimëror</b>		
<i>Universiteti i Tetovës</i>		
Qeverisja korporative	3X4X0.06	0.72
<b>Semestri veror</b>		
Menaxhmenti strategjik	3X4X0.06	0.72
<b>Viti akademik 2019– 2020</b>		
<b>Semestri dimëror</b>		
<i>Universiteti i Evropës Juglindore</i>		
Teoria e organizatës: Një qasje multidisiplinare	3X4X0.06	0.72
<b>GJITHSEJ PIKË NGA ZHVILLIMI I LIGJËRATAVE</b>	<b>93.41</b>	
<b>ZHVILLIMI I LIGJËRATAVE NË SHKOLLA DHE PUNËTORI</b>		

<i>Zhvillimi i ligjëratave në shkolla dhe punëtori në cilësinë e udhëheqësit</i>		
Cikël lekione në menaxhim të burimeve njerëzore në programin professional Professional Logistics & Supply Chain Management; 15.02.2018-14.03.2018	1X1.5	1.5
Cikël leksione mbi përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies në shkollat e mesme në Republikën e Maqedonisë së Veriut	3x1.5	4.5
<b>GJITHSEJ PIKË NGA ZHVILLIMI I LIGJËRATAVE NË SHKOLLA DHE PUNËTORI</b>	<b>6.0</b>	
<b>PËRGADITJE E LËNDËS SË RE</b>		
<i>Përgaditje e ligjeratave në lëndë të re</i>		
Menaxhmenti financiar	1	1
Menaxhimi strategjik i burimeve njerëzore	1	1
Menaxhmenti administrativ biznesor	1	1
Mendimi kritik dhe etika	1	1
Komunikimi i brendëshëm menaxherial	1	1
Menaxhmenti strategjik	1	1
Menaxhmenti ndërkombëtarë	1	1
Menaxhimi i institucioneve publike	1	1
Etika e biznesit	1	1
Lidershipi	1	1
Menaxhimi i marketingut	1	1
Konceptet e menaxhmentit	1	1
Menaxhimi i modeleve të kompetencës	1	1
Qeverisja korporative	1	1
Menaxhimi i punëve gjeodezike	1	1
Zhvillimi i burimeve njerëzore	1	1
Teoritë bashkëkohore të organizimit	1	1
<i>Përgaditje e ushtrimeve në lëndë të re</i>		
Menaxhmenti financiar	1.5	1.5
<b>GJITHSEJ PIKË NGA PËRGADITJA E LËNDËVE TË REJA</b>	<b>17.5</b>	
<b>KONSULTA ME STUDENTË</b>		
<b>Viti akademik 2016-2017</b>		
Menaxhimi strategjik i burimeve njerëzore	9x0.002	0.018
Menaxhimi i burimeve njerëzore	25x0.002	0.05
Menaxhmenti korporativ	53x0.002	0.106
Komunikimi i brendshëm i menaxhmentit	52x0.002	0.104
Menaxhmenti financiar	45x0.002	0.09
Menaxhmenti administrativ-biznesor	12x0.002	0.024
Menaxhimi i burimeve njerëzore	97x0.002	0.194
Menaxhimi i resurseve humane	45x0.002	0.09
Menaxhmenti strategjik	43x0.002	0.086
Menaxhmenti ndërkombëtarë	41x0.002	0.082
Lidershipi	10x0.002	0.02
Etika e biznesit	45x0.002	0.09
Menaxhimi i institucioneve publike	52x0.002	0.104
<b>Viti akademik 2017-2018</b>		

<i>Semestri dimërorë</i>		
Bazat e menaxhmentit	12x0.002	0.024
Menaxhmenti strategjik	40x0.002	0.08
Menaxhimi i marketingut	40x0.002	0.08
Menaxhimi i punëve gjeodezike	16x0.002	0.032
Menaxhimi strategjik i burimeve njerëzore	18x0.002	0.036
Menaxhimi i modeleve të kompetencës	117x0.002	0.234
<i>Semestri verorë</i>		
Bazat e menaxhmentit	50x0.002	0.4
Menaxhmenti strategjik	40x0.002	0.08
Menaxhimi i burimeve njerëzore	110x0.002	0.22
<b>Viti akademik 2018-2019</b>		
<i>Semestri dimërorë</i>		
Bazat e menaxhmentit	12x0.002	0.024
Menaxhmenti strategjik	32x0.002	0.064
Menaxhimi i marketingut	32x0.002	0.064
<i>Semestri verorë</i>		
Bazat e menaxhmentit	70x0.002	0.14
Menaxhmenti strategjik	40x0.002	0.08
Menaxhimi i burimeve njerëzore	70x0.002	0.14
<b>Viti akademik 2019-2020</b>		
<i>Semestri dimërorë</i>		
Menaxhimi i burimeve njerëzore	2x0.002	0.004
Menaxhmenti strategjik	12x0.002	0.024
Menaxhimi i marketingut	12x0.002	0.024
<i>Semestri veror</i>		
Menaxhimi i burimeve njerëzore	100x0.002	0.2
Menaxhmenti strategjik	45x0.002	0.09
Bazat e menaxhmentit	55x0.002	0.11
<b>Viti akademik 2020-2021</b>		
<i>Semestri dimërorë</i>		
Menaxhimi i burimeve njerëzore	10x0.002	0.02
Menaxhmenti strategjik	45x0.002	0.09
Menaxhimi i modeleve të kompetencës	50x0.002	0.1
Teoritë bashkëkohore të organizimit	43x0.002	0.086
Menaxhimi i institucioneve publike	15x0.002	0.03
Menaxhimi strategjik i burimeve njerëzore	2x0.002	0.004
<i>Semestri verorë</i>		
Bazat e menaxhmentit	50x0.002	0.1
Menaxhimi i burimeve njerëzore	70x0.002	0.14
Menaxhment strategjik	60x0.002	0.12
Menaxhimi strategjik i burimeve njerëzore	50x0.002	0.1
Menaxhmenti strategjik i avancuar	40x0.002	0.08
<b>GJITHSEJ PIKË NGA KONSULTAT ME STUDENTË</b>		<b>4</b>
<b>MENTORIM I PUNIMEVE TË DIPLOMIT</b>		

Ilirijana Tairi: "Rekrutimi i fuqisë punëtore efektive si bazë kyçe në sigurimin e fuqisë punëtore efektive. Mbrojtur më datë 17.10.2017	1x0.2	0.2
Majlinda Osmani: "Teoritë përmbajtjesore të motivimit të punëtorëve". Mbrojtur më datë 14.11.2017	1x0.2	0.2
Arife Demiri: "Analiza e pasojave negative të mobingut në vendin e punës". Mbrojtur më datë 14.11.2017	1x0.2	0.2
Florijana Murtezani: "Instrumentet e marketingut miks në ndërmarrjen Eko Shar, Tetovë. Mbrojtur më datë 01.03.2018	1x0.2	0.2
Vllaznim Farizi: "Motivimi i punëtorëve si faktor kyç në ngritjen e produktivitetit të punëtorëve te NVM-të në Tetovë. Mbrojtur më 29. Mars.2018	1x0.2	0.2
Aziz Jashari: "Vlerësimi i performancës së punonjësve". 2017	1x0.2	0.2
Fatmire Emruli: "Analiza e mjedisit të brendshëm". Mbrojtur më datë 21.Qershor.2018	1x0.2	0.2
Agnesa Tairi: "Planifikimi në funksion të suksesit të organizatës së biznesit". Mbrojtur në Nëntor. 2018.	1x0.2	0.2
Drilona Mashkulli: "Menaxhimi i performancës tek ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në komunën e Dibrës". Mbrojtur më 25.06.2019	1x0.2	0.2
Arbnora Elmazi: "Vlerësimi i performancës tek bizneset në regjionin e Tetovës	1x0.2	0.2
